



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 27 maj 2014**

**Numri i lëndës: 2014-07**

**Fitore Rastelica**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 27 maj 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 10 shkurt 2014.

## **II. FAKTET**

2. Ankuesja i ka katër fëmijë me S.R., i cili për momentin jeton në Gjermani.
3. Ajo pohon se më 23 dhjetor 2010, prej burrit të saj dhe familjes së tij ajo ishte detyruar të largohej nga shtëpia e saj ku ishte martuar. Fëmijët e saj tani jetojnë me axhën e tyre, ndërsa ajo jeton me nënën e saj.
4. Më 11 qershor 2012, Gjykata Komunale në Podujevë në përbërje të vetëm një gjykatësi të Kosovës, ka urdhëruar që S.R. t'i paguaj alimentacionin mujor prej 600 eurosh (gjatë qind eurosh) ankuses dhe 130 euro (një qind e tridhjetë euro) fëmijëve të tyre. Më tutje, ankuses ju ishte dhënë kujdestaria e përkohshme e fëmijëve dhe S.R. ju ishin pezulluar të drejtat e tij prindërore.
5. Më 23 janar 2013, Gjykata Komunale në Podujevë në përbërje të vetëm një gjykatësi të Kosovës, ka dhënë një tjetër urdhër dhe ka urdhëruar S.R. t'i paguajë ankuses 450 euro (katër qind e pesëdhjetë eurosh) në muaj për të mbuluar shpenzimet e qirasë së shtëpisë dhe ushqimit.
6. Ajo pohon se vendimet e Gjykatës Komunale nuk janë zbatuar. Për më tepër, ajo pohon se EULEX-i është përfshirë në procedurë, madje e kishte "marrë vendimin e parë", mirëpo ajo nuk ofron asnjë dëshmi në mbështetje të pohimeve të saj.

## **III. ANKESAT**

7. Pa u thirrur në ndonjë dispozitë të instrumentit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ankuesja pohon se të drejtat e saj janë shkelur pasi që vendimet e gjykatës nuk janë ekzekutuar. Ajo duket se ankohet rreth shkeljes së të drejtës së saj për qasje në gjykatë.

## **IV. LIGJI**

8. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

9. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
10. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
11. Paneli konstaton se ankesa e ankueses ka të bëjë me mos zbatimin e dyshuar të vendimeve përfundimtare të marra nga gjykatat e Kosovës. Në këtë drejtim përkujtohet se e drejta për një proces të drejtë e garantuar me nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut i siguron secilit të drejtën që ta sjell në gjykatë apo tribunal çfarëdo pretendimi në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile. Në këtë mënyrë kjo mishëron “të drejtën në një gjykatë”, në të cilën e drejta për qasje që është e drejtë për të filluar një proces gjyqësor në çështjet civile, përbën një aspekt. Megjithatë, kjo e drejtë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor do të lejonte që një vendim përfundimtar dhe detyrues të mbetet i paefektshëm, në dëm të njëjës palë. Do të ishte e pakonceptueshme që neni 6 § 1 të përshkruajë në hollësi garancitë procedurale ndaj palëve ndërgjyqësore, procedurave që janë të drejta, publike dhe të shpejta, pa e mbrojtur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Për ta interpretuar të drejtën për gjykim të drejtë se ka të bëjë vetëm me qasjen në gjykatë dhe kryerjen e procedurave, me të vërtetë ka të ngjarë të çojë në situata që do të ishin në mospërputhje me parimin e sundimit të ligjit. Ekzekutimi i një vendimi që është marrë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e “gjykimit” sa i përket nenit 6 (shih *Burdov kundër Rosisë*, nr. 59498/00, § 34, KEDNj 2002-II; *Hornsby kundër Greqisë*, 19 mars 1997, fq. 510, § 40, Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1997-II). 81. Një vonesë e gjatë e paarsyeshme në zbatimin e një vendimi të detyrueshëm mund të shkel të drejtën e një gjykimi të drejtë. Arsyeshmëria e një vonese të tillë duhet të vlerësohet, duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë kompleksitetin e procedurave të ekzekutimit, sjelljen e vetë aplikantit dhe e autoriteteve kompetente, sasinë dhe natyrën e vendimit të gjykatës (shih *Raylyan kundër Rosisë*, nr. 22000/03, § 31, 15 shkurt 2007).
12. Megjithatë, Paneli konstaton se pavarësisht nga parashtresat e ankuesit, nuk është treguar se EULEX-i ishte i përfshirë në këtë çështje në ndonjë cilësi.
13. Paneli në mënyrë të përsëritur ka gjetur se, në bazë të rregullës 25, paragrafit 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, në parim nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as rreth aspekteve administrative e as rreth aspekteve juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin

gijkues të ndonjë gjykate, nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih midis të tjerash, *E kundër EULEX-it*, 2012-17, 30 gusht 2013, § 23; *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2013-15, 4 shkurt 2014, § 13). Për më tepër, ankuesi nuk ka treguar se gjykatat e Kosovës nuk kanë arritur t'ju qasen në mënyrë të plotë apo siç duhet ndonjë çështjeje të të drejtave të njeriut, të cilën ajo e kishte ngritur në mënyrë valide pranë tyre (*Z kundër EULEX-it*, nr. 2012-06, 10 prill 2013 § 34; *Krasniqi kundër EULEX-it*, nr. 2014-04, 27 maj 2014, §§ 15-16).

14. Rezulton se kjo ankesë bie jashtë kuadrit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe si pasojë jashtë kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

#### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese